REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr./Br. 1079 1090 120
Datë/Datum 22.12.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI IEKSPERTIT SHQYRTUES

Ilir Halili	16.12.2019	*22.12.2020*	1079/20 1090/20
	Data e autorizimit të ekspertit	*Data e dorëzimit të raportit*	*Nr. i lëndës:*

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

*Me datë 10.12.2020, OE : "**Agoniti**"*, ka parashtruar ankesë në OSHP me nr.**1079/20,** kundër njoftimit për dhënie të konratës, në lidhje me aktivitetin e prokurimit **"Furnizim me dru për ngrohje "**, me numër të prokurimit: **VU644-20-2120-1-1-1** iniciuar nga **Autoriteti Kontraktues– KK Vushtrri.**

*Me datë 10.12.2020, OE : "**Milaim Bejta B.I Bushgegu89**"*, ka parashtruar ankesë në OSHP me nr.**1090/20,** kundër njoftimit për dhënie të konratës, në lidhje me aktivitetin e prokurimit **"Furnizim me dru për ngrohje "**, me numër të prokurimit: **VU644-20-2120-1-1-1** iniciuar nga **Autoriteti Kontraktues– KK Vushtrri.**

Data e njoftimit për kontratë 21.05.2020, data e e hapjes së ofertave 19.10.2020, njoftimi për vendimin e AK-26.11.2020, Vendimi mbi refuzimin e Kerkeses per rishqyrtim: 02.12.2020.

Konform nenit 113 dhe 114, Pjesa VIII e LPP-së, Eksperti shqyrtues ka shqyrtuar dhe analizuar pretendimet ankimore sipas nenit 113, te LPP-së.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE (AGONITI)

AK me rastin e njoftimit te kontrates ka bere shkelje te nenit 7,59,72 te LPP-se

AK me rastin e njoftimit per dhenie te kontrates 26.11.2020 ka bere shkelje te nenit 7 te LPP-se sepse ka rekomundar me shperblim te kontrates OE "AOME" shpk i cili ka qene i pa pergjegjshem ngase i njejti nuk e ka plotesuar kriterin e refemcave te njejta per fumizim me dru ,fakt i cili i cili eshte konfirmuar edhe me vendimin e OSHP-se PSH. Nr.596/20 i dt 18.09.2020. Me kete rast AK ka bere favorizim ndaj kompanis te rekomundar me shperblim me kontrate edhe pse i njejti eshte i pa pergjegjshem.

AK me rastin e njoftimit per dhenie te kontrates ka bere shkelje nenit 59 te LPP-se sepse ka rekomunduar nje OE te papergjegjshem me qense i njejti eshte shpallur i pa pergjegjshem edhe me vendim te OSHP-se me numer 596/20 dt 18.09.2020.Andaj sqarimi i AK se i njejti i pergjegjshem eshte i pergjegjshem edhe per kunder faktit se OE i rekomuduar ka ofruar dy lloje te refemcave edhe te "njejta"edhe te "ngjashme"eshte i papranushem dhe ne te njejten kohe qesharak.

AK me rastin e njoftimit per dhenie te kontrates ka bere shkelje te nenit 72 te LPP-se ,sepse AK nga ne nuk ka kerkuar fare sqarime shtese konfrom nenit 72 te LPP-se. Eshte e vertete se heren e pare AK nga ne ka kerkuar sqarime shtese por puntori pergjegjese pran

nderrmarjes time ne ate periudhe i ka pasur prinderit me COVID-19 dhe i njejti ka qene i obliguar te rri ne izolim dhe per kete arsye as ne nuk kemi qene te njoftuar per kete gje nga ana e puntorit tone. Kete fakt ne ia kemi prezentuar edhe AK ne kerkesen tone per rishqyrtim por AK nuk e ka marr per baze fare.Ne potencojme se me dispozitat e reja te LPP-se,kur nje aktivetit i prokuorimit kthehet ne rivlersim kjo nenkupton qe aktviteti fillon nga pika zero dhe se AK konform nenit 72 te LPP-se ka qene i obliguar me rastin e rivleresimit te kerkoj nga ne sqarime shtese,gje te cilen nuk e ka bere.

Andaj nga te cekuart me larte kerkojme nga paneli i OSHP-se qe ankesen tone ta aprovoj si te bazuar dhe kete aktivitet te prokuorimit ta kthj ne rivlersim dhe njekohsishte ta obligoj AK qe me rastin e rivlersimit te kerkoj sqarime shtese nga kompania jone.Gjithashtu kerkojm nga paneli shqyrtus i OSHP-se qe me rastin e mbajtes se seances degjimore te na ftojne edhe ne me qellim te prezentimi e provav tona dhe pretendimeve tona ankimore.

Dëmet Materiale :

Ne si kompani na jane shkaktuar deme materiale ne vlere prej 150 euro ne rastin e pergaditjes se dosjes te tenderit.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE (BUSHGEGU89)

Autoriteti kontraktus-Komuna e Vushtrrise me rastin e zhvillimit te ketij aktivetiti te prokuromit ka bere shkelje te nenit 1,7,59 te LPP-se.

Autoriteti kontraktus me rastin e njoftimi per dhenie te kontrates ka bere shkelje te nenit 1 te LPP-se ,sepse ka rekomundar OE "AOME" shpk.I cili eshte i papergjegjshem sepse te njejtit i mungojn referencat,kontratat e njejta per furnizim me dru.Pra autoriteti kontraktus me apo pa vetedije ka bere edhe demtimin e buxhetit.

AK - me rastin e rekomandimit per dhenie te kontrates per kete aktivitet te prokuorimit ka bere shkelje te nenit 7 te LPP-se ,sepse ka bere favorizim ndaj OE "AOME"shpk, edhe perkunder faktit se i njejti eshte i papergjegjshem per shkak te mungeses se referncave dhe kontratave te njejta per furnizim me dru .Pra AK te njejtit ja ka pranuar referencat dhe kontratat per nje pjese furnizim me dru ,ndersa per pjesen tjeter te mbetur ja ka pranuar referencat dhe kontrata me pelet(te ngjashme).

Vendimi dhe arsyetimi i AK i dt 02.12.2020 kur ne na refuzon kerkesen per rishqyrtim dhe me te cilin vendim mundohet te ja arsyeton referncat dhe kontrata OE "AOME" duke ja pranuar variantin "te njejte" dhe "ngjashme",duke ju referuar vendimit te OSHP-se eshte i papranushem dhe i pa justifikushem per faktin se ne dosje te tenderit kerkesat duhet te jene te qarta dhe se nuk lejohen qe ne dosje te tenderit ,referencat te jene edhe te "njejta" edhe te "ngjashme",por nese i referohemi dispozitave te LPP-se kerkesa - referncat duhet te jene ose "te njejta" ,ose "te ngjashme" e asesi ne te njejten dosje te tenderit referncat nuk pranohen edhe te njejta edhe te ngjashme sepse kjo shkakton konfuzion dhe paqartesi, ky kriter ne rastin konkret eshte i pamatshem.Pra kjo situate eshte e papresdenc ne analet e prokuorimit publik ne Kosove dhe se nga pervoja jone shumevjeqare nuk kemi rastisur asnjehere qe nje AK ne te njejten kohe te kerkoj referenca edhe te njejta edhe te ngjashme ne te njejten dosje te tenderit.Poashtu edhe gjate qasjes ne platformen e OSHP-se dhe qasjes ne vendimet e publikuara te OSHP-se nuk kemi hasur nje presedent te tille ku OSHP-ja ka vertetuar vendime te AK me kete natyre -pra qe te

njejten dosje te tenderit te kemi referenca edhe te njejta edhe te ngjashme dhe ta ka kete vertetuar nje vendim te tille te AK. Neve gjat qasjes ne dokumentacion te tenderit nga ana e pergjegjesit te prokurorimit pran AK na eshte thene gojarisht se ata kane bere llapsus dhe se i eshte pervidhur ne dosje te tenderit kur kane kerkuar referenca dhe kontrata edhe te njejta edhe te ngjashme ne te njejten dosje te tenderit ,por per llapsuse te AK ne nuk munde te demtohemi.

Gjithashtu theksoj se AK nuk na eshte pergjigjur ne pretendimin tone ankimore se OE "AOME" nuk ka prezentuar vertetimin me numer prokuorimi te leshuar nga Agjension Pyjor i Kosoves dhe ne ende mbesim pran pretendimit tone ankimore se ky vertetim i prezentuar nga OE "AOME" munde te jete i falsifikuar andaj lusim ekspertetin shyqrtues te OSHP-se qe ta beje verfikimin e ketij vertetimi ,ngase per te njejtin vertetim AK nga ne ka kerkuar sqarim shtese ne afat prej 3 dite ,ne ju kemi pergjigjur ,ndersa OE "AOME" asnjehere edhe perkunder kerkeses tone nuk i kane bere kerkese per sqarim lidhur me vertetimin ne tjale.

Kurse sa perket pretendimit te OE "AOME" i cili i ka bere ankese ndaj kompanis tone pran OSHP-se me pretendimin se ndaj pronarit te kompanis time ,se i njejti eshte i denuar me aktgjykim te formese se prere ,ne me qellim te sqarimit deklarojme se ky pretendim eshte i pabazuar per faktin se per vepren per te cilen pronari i kompanise eshte i denuar nuk perkon me nenin 65 paragrafi 3.1 3.2 3.3 i LPP-se ,citat"

3.1 **është shpallur fajtor nga një gjykatë kompetente për kryerjen e një vepre penale ose civile duke përfshirë praktikat e korrupsionit, larjen e parave, dhënien e mitos, avantazhe ose aktivitetet e ngjashme me ato të përshkruara në paragrafin 1. të nenit 130 të këtij ligji sipas ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Kosovë ose në cilindo shtet, ose në çfarëdo marrëveshje ose konvente ndërkombëtare;**

3.2 **është deklaruar i papërshtatshëm, kur autoriteti kontraktues zbulon se kjo është një shkelje e rëndë profesionale e konstatuar nga një gjykatë kompetente;**

3.3 **është shpallur fajtor nga një gjykatë kompetente për kryerjen e një vepre penale serioze të pjesëmarrjes në aktivitetet e një organizate kriminale, që përkufizohet si asociacion i strukturuar dhe i krijuar gjatë një periudhe kohore dhe që vepron në mënyrë të organizuar me qëllim të përfitimit financiar përmes veprimeve që konsiderohen si kriminale ose të kundërligjshme në vendin ku ndodhin ato.**

Kurse sa perket paragrafit 3.4 perkitazi me vepren penale te mashtrimit kjo duhet nenkuptuar ne nderlidhshmeri me nenin 3.1,3.2 ,dhe 3.3 te LPP-se ,sepse ligjdhensi nuke ka precizuar se per qfar lloj mashtrimi mund te privohet nga pjesmarrja ne nje tender.por kjo nenkupton se kjo veper penale duhet te jete e nderlidhur me nenin 3.1,3.2 dhe 3.3 gje qe ne rastin konkret ankusi -pronari nuk munde te privohet nga pjesmarrje ne asnje aktivitet te prokuorimit .Lidhur me kete ne ju bashkangjesim edhe parashtresen- vertetimin e gjykates themelore te Gjakoves permes te ciles vertetohet se une nuk kam kurrfar pasoja juridike ngase un kam qene i denuar me gjobe dhe nuk kan pas fare te bej me aktivetet te prokuorimit.

Pra nga permbajte e ketij neni rezulton se une si pronar i kompanise ne fjale nuk e kam konsumar vepren penale te cekur me larte .

AK me rastin e zhvillimit te ketij aktivetit te prokurormit ka bere shkelje te nenit 59 te LPP-se sepse me rastin e vlersimit .krahasimit.egzaminit te tenderve per aktivetin e prokuromit ne fjale ka rekomunduar per shperblim me kontrate OE "AOME" i cili ka qene i pa pergjegjshem dhe eshte i pa pergjegjshem per shkak te mungesese se refernace dhe kontratateve te njejta

dhe vertetimit te Agjensionit Pyjor te Kosoves i cili eshte i pa verfikuar dhe per ne i falsifikuar dhe me afat te skaduar.dhe se i njejti vertetim eshte i nxjerrur para publikimi te njoftimi perkontrate dhe eshte pa numer prokuorimi.
Andaj nga te cekurat me larte i propozoj panelit shqyrtus te OSHP-se qe ankesen tone ta aprovoj si te bazuar dhe kete aktivetit te prokuorimit ta kthej ne rivlersim.Gjithashtu i propzoj panelit shqyrtues te OSHP-se qe gjate shqyrtimit te ankeses tone te na ftoje ne seanc degjimore me qellim te ofrimit te provav tona dhe sqarimeve per pretendimet tona ankimore.

Dëmet Materiale :
Neve na jane shkaktuar deme materiale ne vlere prej 200 euro per shkak te pergaditjes se dosjes se tenderit

KRITERET PËR VLERËSIM

		Kërkesat e përshtatshmërisë: **Kerkesa 1. Operatori ekonomik duhet të përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë të Ligjit Nr. 04 L-042 042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04 L-237, ligjin Nr. 05 L068 dhe Ligjin Nr. 05 L-092 , Neni 65.**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* **Dëshmia 1. Deklarata nën betim që tenderuesi i plotëson Kërkesat për të konkuruar sipas Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04 L-042, Neni 65, duke përdorur formën në Aneksin 2 të Dosjes Tenderit, duhet të jteë e nënshkruar dhe e vulosur.** **Dëshmitë lidhur me kërkesat e pranueshmërisë qe kërkohen nga tenderuesi qe propozohet qe te shpërblehet me kontrate dhe dorëzohen te Autoriteti Kontraktues para publikimit te Njoftimit për Dhënie te Kontratës.** **2. Një vërtetim nga Administrata Tatimore e vendit Tuaj të themelimit se Ju nuk jeni në vonesë për pagimin e tatimeve, ky vërtetim duhet të jetë jo më i vjetër se 90 ditë kalendarike nga data e dorëzimit të tenderit, duhet të dorëzohet nga Op. Ek. të cilit synohet dhënia e kontratës, të dorëzohet në kopje.** **3. Një vërtetim nga " regjistri gjyqësorë " apo në mungesë të tij një dokument ekuivalent i lëshuar nga një autoritet kompetent gjyqësor apo**

			administrativ të vendit të themlimit tuaj , që vërteton se operatori ekonomik ka të drejtë që të merrë pjesë në një aktivitet të prokurimit dhe se ndaj tij nuk ekziston ndonjë rrethanë e përcaktuar me Nenin 65 paragrafi 3.1, 3.3, 3.4, 3.5, 3.6, 4.1, 4.2 dhe 4.4 të LPP-së jo më i vjetër se 6 gjashtë muaj nga data e dorëzimit të tenderit. Apo bazuar në Neni 26.8 i Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik (RROUPP) përcakton se Në rastet kur lëshimi i dokumenteve ose Certifikatave, nën Kërkesat e Përshtatshmërisë ose Përshtatjes Profesionale, nuk janë të arritshme për arsye objektive, ose kur këto dokumente nuk mbulojnë të gjitha rastet për të cilat evidenca duhet të prodhohet, një Deklaratë e shkruar në Betim nga OE mundë të pranohet si evidencë e mjaftueshme. Në kuptim të kësaj si dhe në përputhje me rrethanat e krijuara duke marrë në konsideratë distancimet dhe ose kufizimet sociale si masë mbrojtëse kundër pandemisë së Corona-Virusit COVIT-19, dhe meqenëse në këto rrethana edhe Gjykatat, bazuar në Vendimin KGJK Nr.53 2020 dt. 15 Mars 2020, e kanë kufizuar punën me palë dhe nëse është e pamundur të nxjerrët Vërtetimi nga gjykata (dështmi e kërkuar nga A.K. në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Konratë në bazë të nenit 65, paragrafi 3.1, 3.2, 3.3, 3.4, 3.5, 3.6, 4.1, 4.2 dhe 4.4 të LPP-së) . Ju, duhet të dorzoni një Deklaratë me shkrim nën Betim të vulosur dhe nënshkruar nga personi i autorizuar i O.E., duke i potencuar arsyet objektive për pamundësinë e sjelljes së dështmisë së tillë, duhet të dorëzohet nga Op. Ek. të cilit

			synohet dhënia e kontratës. Dështimi i Operatorit Ekonomik që është propozuar që të shpërblehet me kontratë të sjellë dokumentet e kërkuara në pikat, 2, 3 dhe 4 i jep të drejtë Autoritetit Kontraktues që ofertën ta refuzoj, dhe të vazhdoj me shpërblim të kontratës me Operatorin Ekonomik që është rendit ne vendin e dytë e kështu me radh.
Kërkesat e përshtatshmëri së profesionale	7.1 & 7.2	**Përshtatshmëria profesionale**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*
		Kërkesa 1. Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe ose të korporatës në vendin tuaj të themelimit	**Dëshmia 1. Certifikata e regjistrimit të biznesit e kompletuar, duhet të dorëzohet kopje**
		Kërkesa 2. Certifikata e numrit fiskal	**Dëshmia 2. Certifikata e numrit fiskal valide, duhet të dorëzohet kopje**
		Kërkesa 3. Çertifikata e TVSH-së.	**Dëshmia 3. Çertifikata e TVSH-së valide të dorëzohet në kopje**
		Kërkesa 4. Dëshmi të lëshuar nga Agjencioni Pyjor i Kosovës që Op. Ek. përkatës nuk ka të ngritur ndonjë procedurë për dëme pyjore dhe se nuk ka obligime të pakryera ndaj Agjencionit nga kontratat e mëhershme.	**Dëshmia 2. Një Vërtetim i lëshuar nga Agjencioni Pyjor i Kosovës, duhet dorëzuar në Origjinal**
Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare	8.1 & 8.2	**Kapaciteti ekonomik dhe financiar**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*
		Kërkesa 1. Operatori ekonomik duhet ti ofrojë dëshmi të kënaqshme Autoritetit Kontraktues se qarkullimi vjetor i Operatorit Ekonomik, gjatë tre viteve të fundit (duke filluar nga data e publikimit te Njoftimit për kontrate) ka qenë prej jo më pak se 180,000.00 Euro Në rast Grupi te OE, lideri i Grupit duhet ti ketë 60 % të vlerës së qarkullimit vjetor.	**Dëshmia 1. Raport nga Banka, i vulosur dhe nënshkruar nga një Bankë e licencuar në Kosovë.**
Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose	9.1 & 9.2	**Kapaciteti teknik dhe professional**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*

profesionale		**Kërkesa 1 Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata te furnizimeve te njejta, ne vlere minimale prej 160.000,00 Euro, tri vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit te Njoftimit për kontratë). Në rast Grupi te OE, lideri i Grupit duhet ti ketë 60 % të vlerës së referencave.**	**Dëshmia 1 Listën e nënshkruar dhe të vulosur me të cilën specifikohen të gjitha projektet e furnizimeve të ngjashme të operatorit ekonomik të realizuara në tri vitet e shkuara, ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose raportet e pranimit për kryerje të furnizimeve. (i) kur furnizimet janë kryer për një autoritet publik në Kosovë ose në një vend tjetër, për dëshmi të këtij livrimi shërben kopja e raporteve të pranimit ose referencë ,të rëndësishme të lëshuar ose të bashkënënshkruara nga autoriteti i tillë; (ii) kur furnizimet janë kryer për një blerës privat, për dëshmi të këtij shërben kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i furnizimeve të tilla;**
		Kërkesa 2. Mjete të punës në dispozicion për realizimin e furnizimeve, min. 3 (tre) kamion	**Deshmia 2. Lista e pajisjeve – mjeteve të punës në dispozicion të Op. Ek. për realizimin e furnizimeve, min. 3 (tre) kamion, e pasuar me dëshmi mbi pronësinë e tyre, librezën e qarkullimit të automjetit valide, ose marrëveshjen për marrje me qira të automjeteve nga një Op. Ek. Tjetër.**

RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES (VENDIMI I AK)

Nr.	*Emri dhe adresa e Operatorit Ekonomik*	*Vlera totale e ofertës*
1.	*" AOME "sh.p.k.*	*121.120,00€*
2.	*N.T.P. " Agoniti "*	*157.456,00€*
3.	*" Milaim Bejta B.I. "*	*152.914,00€*
4.	*N.P.T. " Acvilla "*	*149.886,00€*

Komuna e Vushtrrisë **shpërblen** me kontratë O.E.: " **AOME " sh.p.k., me seli në Prishtinë,** në vlerë totale te ofertës **: 121.120,00€.**

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIMEVE TË KËRKUARANGA E EKSPERTËVE SHQYRTUES DHE / OSE TEKNIK

N/A

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP-së

N/A

VENDIMET E MËPARSHMETË PSH-së LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

Vendimi i OSHP-sw nr.809/20 i datws 13.11.2020

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES "AGONITI"

Përgjigje në pretendimin nr.1

Pretendimi kryesorë ankimorë sipas ankesës nr.1079/20 është se OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm, me arsyetim se i njëjti nuk ka ofruar referenca të mjaftueshme sipas kërkesës së dosjes.
Sqarojmë se OSHP përmes vendimit të fundit për këtë qështje, vendimi nr.809/2020 me datë 13.11.2020 ka konstatuar se OE :"AOME" i mbulon kërkesat për projekte të realizuara (AK ka përcaktuar variant "njëjta" dhe "ngjashme").
Bazuar në këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendmi ankimorë është i pabazuar.

Përgjigje në pretendimin nr.2

Lidhur me pretendimin ankimorë se AK nuk ka kërkuar sqarime shtesë, OE pretendon se herën e parë kur i janë kërkuar sqarime puntori i OE i ka pasur pridnerit me COVID-19 dhe i njëjti ka qenë i obliguar të rri në izolim.
Me gjithë këtë OE pretendon se AK është dashur ti kërkoj prap sqarim shtesë me rastin e rivlerësimit.

Eksperti shqyrtues duke pas parasyshë se OE tani i rekomanduar për kontratë, me vendim të OSHP-së është konstatuar se i plotëson kërkesat e dosjes që kontestohen nga OE tjerë, e po ashtu i njëjti është me cmimin më të ulët nga gjithë OE-të pjesëmarrës, vlerëson se kthimi i lëndës në rivlerësim për sqarime shtesë nuk do të sillte ndryshim në rezultat final të këtij aktiviteti të prokurimit.
Bazuar në këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendimi ankimorë është i pabazuar.

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES "Milaim Bejta B.I BUSHGEGU89"

Përgjigje në pretendimin nr.1

Pretendimi kryesorë ankimorë sipas ankesës nr.1090/20 është se OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm, me arsyetim se i njëjti nuk ka ofruar referenca të mjaftueshme sipas kërkesës së dosjes.
Sqarojmë se OSHP përmes vendimit të fundit për këtë qështje, vendimi nr.809/2020 me datë 13.11.2020 ka konstatuar se OE :"AOME" i mbulon kërkesat për projekte të realizuara (AK ka përcaktuar variant "njëjta" dhe "ngjashme").
Bazuar në këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendmi ankimorë është i pabazuar.

Përgjigje në pretendimin nr.2

Pretendimi i dytë ankimorë sipas ankesës 1090/20 është se vërtetimi i APK për OE të rekomanduar për kontratë "mund" të jetë i falsifikuar.
Eksperti shqyrtues sqaron se nuk kemi autoritet, e as kapacitet teknik/professional për tu përgjigjur në një pretendim të tillë ankimorë. Mendojmë që OE ankues për pretendime të tilla do duhej drejtuar organeve kompetente.
Në të njëjtën kohë OSHP përmes vendimit nr.809/20 ka vlerësuar se :

"inicimi i një procedure ndaj një operatori ekonomik të caktuar nuk e penalizon apo përjashton nga pjesëmarrja në një aktivitet të prokurimit apo të kontraktoj një punë të caktuar, përkatësisht nuk plotësohen kushtet e përcaktuara në nenin 65 të LPP-së për përjashtim nga procedura e prokurimit apo eliminim të operatorit ekonomik".

Ndërsa sa i përket qështjes se pronari i OE ankues (më herët i rekomanduar për kontratë) është i dënuar për vepër penale, sqarojmë se edhe kjo qështje është trajtuar përmes vendimit të OSHP-së nr.809/20 të datës 13.11.2020, me të cilin rast OSHP ka konstatuar se rekomandimi për kontratë ishte bërë në kundërshtim me nenin 65 të LPP-së.
Bazuar në këto që u cekën më lartë vlerësojmë se pretendimi ankimorë është i pabazuar.

MENDIMI i EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesat e OE-ve ankues të refuzohen si të pabazuara, ndërsa të vërtetohet vendimi i AK-së për dhënie të kontratës.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – KK Ferizaj
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – Agoniti
- OE ankues – Bushgegu89
-